

**VËZHGIMI NDËRKOMBËTAR I ZGJEDHJEVE**  
**Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë**  
**Zgjedhje parlamentare të parakohshme – 5 qershor 2011**

---

**DEKLARATA PËR REZULTATET DHE KONKLuzionET PRELIMINARE**

**Shkup, 6 qershor 2011** - Deklarata për rezultatet dhe konkluzionet preliminare është rezultat i një pune të përbashkët mes Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut pranë OSBE-së (OSBE/ODIHR), Asamblesë Parlamentare të OSBE-së (AP OSBE) dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE).

Z. Roberto Batelli (Slloveni), Përgjegjës për çështje financiare dhe Shef i delegacionit të AP OSBE, u emërua nga Kryesuesi i OSBE-së si Koordinator special për të udhëhequr misionin afatshkurtër vëzhgues. Z. Jean-Charles Gardetto (Monako) kryesoi delegacionin e APKE-s. Z. Julian Peel Yates është Shefi i Misionit Vëzhgues të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR.

Procesi zgjedhor vlerësohet nga aspekti i përmbushjes së përkushtimeve të OSBE-së dhe standardeve të Këshillit të Evropës, si dhe të legjislacionit kombëtar. Deklarata për rezultatet dhe përfundimet preliminare dorëzohet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, duke përfshirë paraqitjen tabelore dhe shpalljen e rezultateve, trajtimin e ankesave dhe apeleve të mundshme ditën pas zgjedhjeve. OSBE/ODIHR do të përgatisë dhe botojë një raport të plotë përfundimtar, duke përfshirë edhe rekomandimet për përmirësime të mundshme, afërsisht tetë javë pas përfundimit të procesit zgjedhor. AP OSBE do të paraqes raportin e saj më 6 korrik në Komitetin e përhershëm të saj në Beograd. APKE do të paraqes raportin e saj në seancën e Asamblesë e cila do të mbahet në qershor, 2011.

---

**KONKLuzionET PRELIMINARE**

---

Zgjedhjet e parakohshme të 5 qershorit ishin konkurrencte, transparente dhe mirë të administruara mbarë vendit, megjithëse disa aspekte kërkojnë vëmendje shtesë. Në ditën e zgjedhjeve, votuesit kishin mundësinë lirisht të shprehin zgjedhjen e tyre në ambient të qetë, përkundër disa deklaratave të papërgjegjshme të partive politike për parregullsi.

Liria e shprehjes, lëvizjes, dhe tubimit u respektua dhe kandidatët patën mundësi të zhvillojnë fushatën lirshëm. Zgjedhjet ndodhën në një ambient të bojkotit parlamentar dhe nivelit të lartë të mosbesimit mes partive në pushtet dhe në opozitë, që shpesh u pasqyrua me retorikë të fuqishme gjatë fushatës.

*Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.  
Janë siguruar përkthime jozyrtare në shqip dhe maqedonisht.*

## **vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve**

**Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Zgjedhje të parakohshme, 5 qershor 2011**

### **Deklarata për rezultatet dhe konkluzionet preliminare**

---

Edhe pse të gjitha partitë politike u angazhuan për zgjedhje demokratike, të lira dhe pa kërcënime, vazhduan akuzat e ndërsjella për frikësime të votuesve dhe shpërdorimit të fondeve shtetërore. Megjithatë, zhvillimi i përgjithshëm i fushatës ishte i qetë dhe diskret mbarë vendit.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KShZ) kryesisht punoi në mënyrë kolegjiale dhe efikase. Përkundër kornizës kohore të ngushtë për zgjedhjet e parakohshme, KShZ arriti që të kryente të shumtën e përgatitjeve në kohë. Votimi për çështje të ndjeshme politike shpeshherë bëhej sipas përcaktimeve partiake dhe prania e mediave gjatë seancave të KShZ-së pati tendencë të zmadhimit të ndarjeve partiake.

Megjithëse disa dispozita u ndryshuan në mënyrë të konsiderueshme dy muaj para zgjedhjeve dhe pa mbështetjen e opozitës, Kodi Zgjedhor i rishqyrtuar siguron një bazë të fortë teknike për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike nëse zbatohet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Por, mbeten boshllëqe dhe paqartësi, veçanërisht sa u përket dispozitave në lidhje me ankesat, votimit jashtë vendit, dhe përdorimit të burimeve administrative.

KShZ shprehu bindjen se listat e votuesve ishin të cilësisë së lartë. Por, shqetësimet të kamotshme për saktësinë e listës së votuesve vazhduan të shprehen nga shumë bashkëfolës. Për herë të parë, 7,285 qytetarë që jetojnë jashtë vendit shfrytëzuan rastin për t'u regjistruar për votim jashtë vendit.

Elektorati kishte në dispozicion zgjedhje të gjerë dhe të shumtë të kandidatëve, përfshirë dy koalicione të gjera, njëri i prirë nga partia në pushtet Organizata e brendshme revolucionare e Maqedonisë – Partia demokratike e unitetit nacional maqedonas (VMRO-DPMNE), dhe tjetri i prirë nga Lidhja social demokrate e Maqedonisë (LSDM), si dhe 16 parti politike.

Përderisa e shumta e akuzave për frikësime të votuesve nuk kishin baza të mjaftueshme, fushatat për dalje në votim, veçanërisht ato nga partia në pushtet, shpesh nuk ndanin në mënyrë përkatëse aktivitetet partiake nga ato shtetërore. Mosndarja e mjaftueshme e aktiviteteve shtetërore nga ato partiake nuk është në pajtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të OSBE-së nga Kopenhaga më 1990. Vëzhguesit gjithashtu i vlerësuan si të besueshme akuzat për presion mbi nëpunësit shtetërorë për të mbështetur koalicionin qeveritar. Përveç kësaj, ata vërejtën edhe raste të shpërdorimit të resurseve administrative.

Numër i madh mediash votuesve u ofruan raportim të llojllojshëm dhe të gjerë duke iu mundësuar të bënin një zgjedhje të informuar. Megjithatë, e shumta e mediave përcillnin politika redaktuese partiake dhe iu mungonte analiza dhe vlerësimi kritik, shpesh duke i përzier faktet me komentet redaktuese. Monitorimi i mediave nga MVZ i OSBE/ODIHR tregoi se sasia dhe përmbajtja e mbulimit të fushatës nga televizioni publik ndjeshëm ka

*Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.  
Janë siguruar përkthime jozyrtare në shqip dhe maqedonisht.*

**vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve**

**Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Zgjedhje të parakohshme, 5 qershor  
2011**

**Deklarata për rezultatet dhe konkluzionet preliminare**

---

favorizuar partitë në pushtet, që është në kundërshtim me detyrimet dhe mandatin e mediumit publik.

*Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.  
Janë siguruar përkthime jozyrtare në shqip dhe maqedonisht.*

## **vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve**

**Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Zgjedhje të parakohshme, 5 qershor 2011**

### **Deklarata për rezultatet dhe konkluzionet preliminare**

---

Shumë pak ankesa zyrtare u paraqitën në KShZ dhe asnjë në gjykatat. KShZ nuk arriti të përcaktonte procedurat për të trajtuar ankesat, që rezultoi me vendime jokonzistente dhe jo në kohë. Bashkëbiseduesit justifikuan mungesën e ankesave në gjykata me besimin e ulët në procedurat e ankimit dhe organet gjyqësore.

U respektuan dispozitat e Kodit Zgjedhor për përfaqësimin gjinor në listat e kandidatëve dhe komisionet zgjedhore. Përjashtimi i vetëm ishte KShZ-ja, ku nga shtatë anëtarët ka vetëm një grua. Megjithëse dukshmëria e grave gjatë fushatës mbeti e ulët, numri i tyre si kryesuese të listave u rrit.

Partitë politike pothuajse pa përjashtim zhvilluan fushatat në linja etnike, duke pasqyruar kështu polarizimin ekzistues të shoqërisë.

Dita e zgjedhjeve, duke përfshirë edhe votimin e parakohshëm, nga ana e vëzhguesve ndërkombëtar u vlerësua si jashtëzakonisht pozitive, pa ndonjë dallim të theksuar mes mjediseve maqedonase dhe ato etnike shqiptare. Votimi u zhvillua në atmosferë të qetë. Numërimi u vlerësua pozitivisht në nëntë nga dhjetë numërimet e vëzhguara. Natën e zgjedhjeve, KShZ publikoi rezultate të detajuara zgjedhore sipas vendvotimeve.

---

#### TË GJETURAT PRELIMINARE

---

### **Historiat**

Parlamenti miratoi shpërbërjen e tij më 14 prill dhe u shpallën zgjedhje parlamentare të parakohshme për më 5 qershor, zgjedhje të dyta parlamentare të parakohshme të njëpasnjëshme. Zgjedhjet vijuan pas një bojkoti më të gjatë të parlamentit nga ana e partive opozitare, të prira nga LSDM-ja. Bojkoti filloi më 28 janar si përgjigje ndaj ngrirjes së llogarive bankare të katër mediave si pjesë e një hetimi penal lidhur me pronarin e *Televizionit A1*, që konsiderohet si mediumi me qëndrime më kritike ndaj pushtetit. Partitë opozitare gjithashtu deklaruan se nuk kishte mundësi për një dialog të vërtetë mes tyre dhe koalicionit mazhoritar të prirë nga VMRO-DPMNE.

Gjithsej 123 deputet do të zgjidhen për një mandat katër vjeçar. 120 deputet u zgjedhën me sistemin proporcional të përfaqësimit nga gjashtë njësi zgjedhore, dhe, për herë të parë, nga një deputet u zgjodh me sistemin mazhoritar nga secila nga tri njësitë jashtë vendit në Evropë dhe Afrikë, në Amerikën Veriore dhe Jugore, dhe në Australi dhe Azi. Nuk ka prag të daljes për zgjedhjen e 120 deputetëve. Por, për kandidatët jashtë vendit duhet të dalin së paku 2 për qind nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar në njësinë përkatëse që zgjedhjet të jenë të suksesshme.

Zgjedhjet kryesisht konsiderohen një test i rëndësishëm për vendin në kontekst të aspiratave të përbashkëta të të gjitha palëve të spektrit politik për integrim Euro-Atlantik.

*Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.  
Janë siguruar përkthime jozyrtare në shqip dhe maqedonisht.*

## **vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve**

**Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Zgjedhje të parakohshme, 5 qershor 2011**

### **Deklarata për rezultatet dhe konkluzionet preliminare**

---

#### **Korniza Ligjore**

Kodi zgjedhor (KZ) është ligji kryesor që rregullon zgjedhjet parlamentare. Disa dispozita pësuan ndryshime të konsiderueshme në prill të vitit 2011, të miratuara nga një shumicë e vogël në parlament, dhe me bojkotim të parlamentit nga ana e partive opozitare<sup>1</sup>. Megjithëse amendamentet ishin pjesë e një procesi të gjatë konsultativ, në të nuk morën pjesë të gjitha partitë politike.

Më tej, ndryshimi i kornizës ligjore pak para zgjedhjeve nuk është në pajtim me Kodin e praktikave të mira në çështje zgjedhore të Komisionit Venecian të Këshillit të Evropës dhe ndikon mbi zbatimin në kohë dhe konzistent të ligjit. Pasi shumë afate zgjedhore u shkurtuan për pesë ditë për zgjedhjet e parakohshme, u ngrit pyetja nëse do të arrihej që të bëhen përgatitjet e nevojshme dhe të përcillen informatat përkatëse deri te aktorët zgjedhorë para zgjedhjeve.

Kjo vlente në veçanti për zgjedhjet jashtë vendit që u zhvilluan për herë të parë. Shumë çështje në lidhje me procedurën nuk u trajtuan duke përfshirë edhe atë se si do të japin votën anëtarët e Këshillave zgjedhorë (KZ) jashtë vendit. Më tej, qytetarët që qëndrojnë jashtë por nuk e plotësojnë kushtin e qëndrimit minimal prej tre muajsh për t'u regjistruar, si dhe ata që u regjistruan në zyrat diplomatike dhe konsullare ku janë regjistruar më pak se dhjetë votues, në fakt ju është marrë e drejta e votimit.<sup>2</sup> Numri i vogël i votuesve të cilët u regjistruan për votim jashtë vendit shtron pyetjen e barazisë mes votuesve në vend dhe atyre jashtë vendit.<sup>3</sup>

Në drejtim pozitiv, transparenca e financimit të fushatës është përmirësuar me kërkesën që partitë të paraqesin një raport të përkohshëm në lidhje me shpenzimet e tyre për fushatën në KShZ, Entin Shtetëror të Revizionit dhe Komisionin Shtetëror për Ndalimin e Korrupsionit (KShNK). Sipas këtyre institucioneve, të gjitha raportet u dorëzuan në kohë. Megjithëse nuk ka afat për shqyrtimin e raporteve që dorëzohen një ditë para zgjedhjeve, e shumta e raporteve u bënë publike më 27 maj. KShNK gjithashtu lëshoi një vlerësim të raporteve të paraqitura, ku theksoi disa mangësi.

#### **Administrata zgjedhore**

Zgjedhjet u administruan nga një administratë zgjedhore trepalëshe duke përfshirë KShZ-në, 85 Këshilla Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), dhe 2,976 KZ në vend, dhe 36 KZ të vendosura në zyrat diplomatike dhe konsullare jashtë vendit.

---

<sup>1</sup> Më 5 prill, 2011 u miratuan amendamente të rëndësishme në KZ (68 nga 120 deputetë). Në plotësim, më 13 prill u ndryshuan kufinj të dy njësive zgjedhore.

<sup>2</sup> Neni 2 (17) nga KZ. Vetëm ato qytetarë të cilën kanë leje për qëndrim për më së paku tre muaj bien nën definicionin e atyre që janë "përkohësisht jashtë". Sipas nenit 165 (2) nga KZ, një vendvotim nuk mund të krijohet nëse janë regjistruar më pak se dhjetë votues.

<sup>3</sup> Neni 2 i Kushtetutës dhe paragrafi 7.3 nga OSBE Dokumenti i Kopenhagës i vitit 1990 parashohin barazi mes votave.

***Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.  
Janë siguruar përkthime jozyrtare në shqip dhe maqedonisht.***

## **vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve**

**Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Zgjedhje të parakohshme, 5 qershor 2011**

### **Deklarata për rezultatet dhe konkluzionet preliminare**

---

Kryetari i KShZ-së dhe dy anëtarë emërohen nga partitë parlamentare në opozitë, ndërsa nënkryetari dhe tre anëtarët emërohen nga partia në pushtet. KShZ ka punuar kryesisht në mënyrë kolegjiale dhe efikase. Në përgjithësi, KShZ ka punuar në mënyrë transparente. Seancat e KShZ-së ishin të hapura për vëzhguesit e huaj dhe local, dhe për mediat. Megjithatë, disa vendime të rëndësishme, siç janë ato për dukjen dhe shtypjen të fletëvotimeve dhe akreditimin e disa vëzhguesve, u sollën në grupe pune që nuk ishin publike dhe pa votim formal.<sup>4</sup> Vendimet për çështje të ndjeshme politike shpeshherë bëheshin sipas bindjeve partiake dhe prania e mediave kishte tendencën të zmadhojë edhe më shumë ndarjet partiake. Megjithëse pati vonesa në arritjen e disa afateve, përgatitjet për zgjedhjet u zhvilluan në kohë.

KKZ-të janë organe profesionale dhe pesë anëtarët e tyre zgjidhen nga radhët e nëpunësve shtetërorë. Vëzhguesit ndërkombëtar raportuan se bashkëpunimi në KKZ-të ishte i mirë dhe sillnin vendime të njëzëshme. Megjithatë, të gjitha KKZ-të informuan MVZ të OSBE/ODIHR se financat kanë ardhur vonë nga KShZ që ka bërë që disa nga kryetarët e KKZ-ve të përdorin paratë e tyre për të mbështetur funksionimin e KKZ-ve.

Nga ana tjetër, KZ-ët janë përbërë duke përdorur një model të përzier profesional-politik, me një anëtar të emëruar nga partitë politike në pushtet, një nga partitë opozitare, dhe tre anëtarë të zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga radhët e nëpunësve shtetërorë.

KShZ zhvilloi një program trajnimi të detyrueshëm për të gjitha komisionet zgjedhore të nivelit më të ulët. U miratuan dhe u publikuan dy doracakë për trajnim, që u përdorën nga KKZ-të si zëvendësim për rregulloret për punën e KKZ-ve dhe KZ-ve.

KShZ zhvilloi program të kufizuar për votuesit dhjetë ditë para ditës së zgjedhjeve, i përbërë nga dy videoklipe, fletushka dhe udhëzime për votim që kanë për qëllim të nxisin votuesit të marrin pjesë, të shpjegojnë procesin e votimit, dhe të paralajmërojnë kundër shkeljeve zgjedhore.

### **Listat votuese dhe regjistrimi**

Përgjegjësinë e azhurnimit dhe mirëmbajtjes së listës votuese (LV), për herë të parë e ka KShZ-ja. Inspektimi publik i ekstrakteve të LV-ës u zhvillua prej 25 prill deri më 4 maj. Ekstraktet e LV-ës ishin në dispozicion për verifikim në zyrat rajonale dhe lokale të KShZ-ës, përmes një programi internet për kërkim, dhe duke dërguar e-mail deri te zyra

---

<sup>4</sup> Neni 4 i KZ parasheh që puna e të gjitha komisioneve zgjedhore të bëhet në mënyrë publike.

## **vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve**

**Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Zgjedhje të parakohshme, 5 qershor 2011**

### **Deklarata për rezultatet dhe konkluzionet preliminare**

---

përkatese e KShZ-së.<sup>5</sup> KShZ njoftoi më 15 maj se LV përfundimtare për këto zgjedhje përmban 1,821,122 votues në vend dhe gjithsej 7,258 votues të regjistruar jashtë vendit.<sup>6</sup>

Megjithëse KShZ shprehu besimin se LV-ët janë më cilësi të lartë, shumë bashkëbisedues shprehën shqetësimet e tyre të kamotshme rreth saktësisë së LV-ve. Me një popullatë prej 2,050,671 mbetet shqetësimi se numri i votuesve në LV-ët është i fryrë.<sup>7</sup> Mbeten për tu realizuar rekomandimet e përsëritura të OSBE-ODIHR dhe Komisionit Venecian se duhet të bëhet një verifikim i detajuar i LV-ve.

### **Regjistrimi i kandidatëve**

Në zgjedhjet parlamentare mund të marrin pjesë kandidatë të emëruar nga partitë politike, koalicionet e partive politike, ose kandidatë të pavarur të emëruar nga grupe të votuesve. Dy koalicionet e gjera, njëri i udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe njëri nga LSDM, si dhe 16 parti politike paraqitën lista të kandidatëve në kohë dhe garuan në këto zgjedhje. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE përfshin 22 parti dhe koalicioni i udhëhequr nga LSDM përfshin 15 parti. Të dy koalicionet në radhët e tyre kanë edhe parti nga komunitetet etnike më të vogla. Të gjitha partitë shqiptare dolën në zgjedhje vetë, duke përfshirë edhe Bashkimin Demokratik për Integrim (BDI) dhe Partin Demokratike Shqiptare (PDSH). Listat e kandidatëve që u paraqitën nga një parti dhe nga një grup qytetarësh nuk i plotësuan kushtet dhe me të drejtë nuk u regjistruan nga KShZ.

### **Atmosfera gjatë fushatës**

Megjithëse zgjedhjet ndodhën në kushte të bojkotimit parlamentar dhe një nivel të ndjeshëm mosbesimi mes partive opozitare dhe atyre në pushtet, atmosfera e përgjithshme gjatë fushatës ishte e qetë dhe diskrete, në veçanti jashtë Shkupit. E shumta e kandidatëve përdorën fjalor neutral dhe ftuan mbështetësit e tyre të sillen në mënyrë të qetë dhe t'i shmangen dhunës; megjithatë, kishte disa raste të një retorike të fuqishme dhe fjalori nxitës.

Disa parti në mënyrë aktive promovuan veten para fillimit zyrtar të fushatës. Partitë patën mundësinë të zhvillojnë fushatën e tyre lirisht dhe liria e shprehjes, lëvizjes dhe tubimit kryesisht u respektua.<sup>8</sup>

---

5 Sipas informatave të botuara në ueb faqen e KShZ-ës, gjatë kësaj periudhe në zyrat rajonale të KShZ-ës 18,662 njerëz i kanë kontrolluar të dhënat e tyre, nga të cilët 42 ishin votues të sapo regjistruar, 842 të vdekur u fshinë, 210 ndryshime të të dhënave personale u kërkuan nga vetë qytetarët dhe 24 persona të cilët aplikuan që të regjistrohen u rrefuzuan.

6 4,653 në njësinë zgjedhore shtatë e cila e përfshin Evropën dhe Afrikën, 1,832 në njësinë zgjedhore tetë e cila përfshin Amerikën Veriore dhe Jugore dhe 773 në njësinë zgjedhore nëntë e cila përfshin Australinë dhe Azinë.

7 Numri i përgjithshëm i popullatës për vitin 2009 sipas Entit Shtetëror Statistikor. Shih: [www.stat.gov.mk/OblastOpsto\\_eng.aspx?id=2](http://www.stat.gov.mk/OblastOpsto_eng.aspx?id=2).

8 Një përjashtim ishte ndalimi i LSDM-ës që të mbajë miting në qendër të Shkupit më 12 maj nga kryetari i komunës së Shkupit.

***Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.  
Janë siguruar përkthime jozyrtare në shqip dhe maqedonisht.***

## **vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve**

**Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Zgjedhje të parakohshme, 5 qershor 2011**

### **Deklarata për rezultatet dhe konkluzionet preliminare**

---

Çështjet ndëretnike në masë të madhe munguan në fushatën zgjedhore, dhe partitë zhvilluan fushatat duke përcjellë vijat etnike. Çështjet e interesit të përbashkët siç janë zhvillimi ekonomik, varfëria dhe papunësia, integrimi në BE dhe NATO dhe emri i shtetit u pasqyruan në të shumtën e platformave të partive politike, dhe janë interpretuar sipas interesave etnike të bashkësive.

Fushata kryesisht u zhvillua në formë të tubimeve dhe grumbullimeve të vogla mbarë vendit.<sup>9</sup> Përderisa VMRO-DPMNE përdori në masë të madhe bilbordat dhe afisheet mbarë vendit,<sup>10</sup> garuesit e tjerë vendosën mos ta bënin këtë dhe u mblodhën në tubime të vogla, fushata prej dere në derë, dhe në mediat shoqërore, pjesërisht duke ia atribuar këtë mungesës së mjeteve financiare.

Pjesëmarrësit në zgjedhje në nivel lokal shpeshherë u angazhuan në bashkëpunim konstruktiv dhe morën një qëndrim respekti ndaj njëri tjetrit. Ka shembuj të marrëveshjeve rreth dhënies së hapësirave të lira për afishe dhe koordinim të orareve të tubimeve, si dhe ndeshje të futbollit mes aktivistëve të BDI-së dhe PDSH-së në Likovë. Ambienti në kampin politik shqiptar ishte kryesisht i qetë, për të cilin duket se ka ndihmuar marrëveshja mes BDI-së dhe PDSH-së për zgjedhje të qeta dhe demokratike.

Në një numër incidentesh kryesisht të vogla ku u dëmtuan zyra partiake, u raportuan në MVZ të OSBE/ODIHR-së dhe Ministrinë për Punë të Brendshme (MPB). MPB informoi për njëzet e tetë raste të dëmtimeve të shtabeve zgjedhore.<sup>11</sup> Disa nga këto u ekzagjeruan me qëllim të tërhiqet vëmendja e mediave.

Gjatë periudhës parazgjedhore, vëzhguesit afatgjatë të OSBE/ODIHR u njoftuan me akuzat se aktivistë partiak kishin kërkuar nga nëpunës shtetërorë të japin një numër të caktuar të votuesve të cilët do të votonin për partinë në pushtet. Sipas këtyre akuzave, është përdorur presion për ta arritur këtë. MVZ i OSBE/ODIHR-së posedon dy e-mail ku shihet se kërkesa është bërë nga aktivist i partisë VMRO-DPMNE deri të kryetarët e komunave dhe institucioneve arsimore para se të shpallen zgjedhjet.<sup>12</sup> Këto e-maila dhe vërejtje të tjera që janë bërë nga vëzhguesit afatgjatë të OSBE/ODIHR për shpërdorimin e resurseve shtetërore i bëjnë këto akuza të besueshme. Veç kësaj, Ministri i punëve të brendshme ka hyrë në dosjet penale të disa përfaqësuesve të autorizuar të LSDM-së të cilët janë caktuar të vëzhgojnë zgjedhjet dhe këto informata i ka dorëzuar deri në KShZ me kërkesë që t'u refuzohet akreditimi. Më 19 maj, Kryeministri ka lëshuar një letër të hapur me të cilën apelon deri të udhëheqësit e institucioneve shtetërore dhe nëpunësit shtetërorë “të garantojnë lirinë e zgjedhjes”. Por, letra gjithashtu flet edhe për “sulm nga

---

9 MVZ i OSBE/ODIHR-ës vëzhgoi 73 mitingje mbarë vendit.

10 Kjo gjithashtu është reflektuar në raportet e para për financimin e fushatës. VMRO-DPMNE paraqiti shpenzime për propagandë komerciale në shumë prej 85.9 milion MKD, ndërsa LSDM shpenzoi gjithsej 9.9 milion MKD.

11 Disa herë janë thyer dritaret e shtabeve zgjedhore të BDI-së, PCER, VMRO-DPMNE-së, LSDM-ës, Unionit të romëve në Maqedoni dhe të Bashkuar për Maqedoninë në Manastirë, Kavadar, Kërçovë, Kumanovë, Radovish, Prilep, Shkup dhe Tetovë.

12 MVZ i OSBE/ODIHR-ës posedon kopje të listave me emrat e kërkuar.

***Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.  
Janë siguruar përkthime jozyrtare në shqip dhe maqedonisht.***



## **vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve**

**Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Zgjedhje të parakohshme, 5 qershor 2011**

### **Deklarata për rezultatet dhe konkluzionet preliminare**

---

oponentët tanë politik” dhe “çdo sulm të pabazë nga opozita.” E gjithë kjo dëshmon ndarjen e pamjaftueshme mes shtetit dhe partisë, në kundërshtim me përcaktimet në paragrafin 5.4 të Dokumentit të OSBE-së nga Kopenhaga e vitit 1990.

Megjithëse nuk u ngrit si çështje gjatë fushatës, madje as nga ana e opozitës, Neni 9 i KZ-së parasheh që “zyrtarët e autorizuar” të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes të ndalin përkohësisht detyrat e tyre zyrtare pasi të jenë verifikuar si kandidatë. Kur kjo çështje u hap me VMRO-DPMNE, ata u pajtuan se Ministrat ishin “zyrtarë të autorizuar” sipas nenit 9. Por, interpretimi i tyre ishte se neni nuk kishte të bëjë me ministrat, sepse sipas Ligjit për nëpunës shtetërorë, ata janë anëtarë të qeverisë dhe jo të punësuar të ministrisë përkatëse.

### **Mediat**

Numër i madh i mediave u ofruan votuesve raportim të llojllojshëm dhe të gjerë duke iu mundësuar të bënin një zgjedhje të informuar. Megjithatë, e shumta e mediave përcillnin politika redaktuese partiake dhe iu mungonte analizë dhe vlerësim kritik, shpesh duke i përzier faktet me komentet editoriale.

Raportimi për fushatën zgjedhore rregullohet me KZ-në dhe Ligjin për veprimtari radiodifuzive (LVR). Këshilli i radiodifuzionit (KR), subjekti kryesor rregullator për mediat elektronike, sollti një rregullore të posaçme për raportimin e mediave para dhe gjatë periudhës së fushatës. KR ka gjithashtu për detyrë të monitorojë mediat dhe të reagojë në rast të parregullsisve. Monitorimi i KR-së nxori në pah mungesën e balancit në raportimin që bënin shumica e mediave elektronike. Gjatë fushatës zyrtare KR ngriti nëntë akuza për kundërvajtje kundër tetë stacioneve televizive për shkelje të rregullave për prezantimin e reklamave dhe sondazheve të opinionit publik. Më tej u ngritën edhe dy akuza për kundërvajtje kundër televizionit publik *MTVI* dhe televizionit privat *AI* për thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Radiodifuzeri publik *MTV-1* respektoi detyrimin ligjor për t’u dhënë kohë falas partive politike dhe 13 parti shfrytëzuan këtë mundësi. *MTV-1* dhe *MTV-2* krijuan një program special i quajtur “Kronika e zgjedhjeve”, për të mbuluar aktivitete zgjedhore të garuesve. Por, koha falas dhe “Kronika e zgjedhjeve” zakonisht transmetoheshin jashtë kohës me shikueshmëri të lartë, duke kufizuar kështu publikun potencial.

Rezultatet nga monitorimi i zhvilluar nga MVZ i OSBE/ODIHR treguan anshmëri të theksuar nga aspekti i sasisë dhe përmbajtjes tek mediat e monitoruara. Në kundërshtim me detyrimet ligjore dhe mandatin publik që e ka, mbulimi i fushatës nga *MTV-1* favorizonte qeverinë dhe fuqimisht kritikonte opozitën.<sup>13</sup> Ndërsa koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE i jepej diku 20 për qind nga mbulimi kryesisht pozitiv dhe neutral,

---

13 Neni 6 nga Rregullorja për Qasje të Barabartë në Media gjatë Fushatës Zgjedhore (Rregullorja për Media); Neni 75 (5) i KZ; Neni 80 nga LVR.

## **vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve**

**Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Zgjedhje të parakohshme, 5 qershor 2011**

### **Deklarata për rezultatet dhe konkluzionet preliminare**

---

koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja kishte 19 për qind të mbulimit, kryesisht me ton negativ. *MTV-2* i kushtoi 19 për qind të mbulimit partisë qeverisëse BDI-së. *MTV-1* dhe *MTV-2* u dhanë 35 dhe 23 për qind, respektivisht, zyrtarëve qeveritarë. Raportimi shpesh nuk bënte dallimin mes rolit të tyre si kandidatë dhe si zyrtarë qeveritarë.<sup>14</sup>

*A1 Televizion*, kanali televizivë më i popullarizuar, i kushtoi 20 për qind të mbulimit kryesisht neutral LSDM-së, dhe 30 për qind të mbulimit tepër kritik partisë qeverisëse. Nga ana tjetër, kanalet private *Sitel* dhe *Kanal 5* i kushtuan 38 respektivisht 32 për qind, të mbulimit kryesisht pozitiv koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE, ndërsa koalicionit të udhëhequr nga LSDM iu dha 32 respektivisht 29 për qind, të mbulimit pothuajse në tërësi negativ. *TV Telma* adoptoi një qëndrim më të balancuar, megjithëse mbulimi ishte kryesisht kritik ndaj koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Mbulimi i *Alsat-M* i aktorëve kryesorë në zgjedhje ishte kryesisht neutral. *Sitel* dhe *Kanal 5* gjithashtu në mbulimin e tyre bashkuan funksionet e zyrtarëve qeveritarë me kandidatë partiak që kanë poste zyrtare.

Përkundër planit fillestar, *MTV-1* nuk organizoi debate zgjedhore. *MTV-2* organizoi 5 debate mes partive etnike shqiptare. Disa kanale televizive private gjithashtu mbajtën debate mes partive politike. VMRO-DPMNE vendosi mos të merrte pjesë në asnjë debat gjatë fushatës zgjedhore.

Vetëm disa parti shfrytëzuan në masë të madhe reklamën politike të paguara. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE ishte i vetmi pjesëmarrës në zgjedhje që u reklamua në *Kanal 5* dhe *Sitel*. Disa reklama të koalicionit të udhëhequr nga LSDM dhe parti tjera opozitare emitoheshin në *Televizionin A1*, *Alsat-M* dhe *Telma*.

Mediat e shtypura prezantuan pikëpamje të llojllojshme. Derisa *Dnevnik* dhe *Nova Makedonija* kryesisht dhanë një fotografi të balancuar të fushatës, ata ishin më kritik ndaj koalicionit të udhëhequr nga LSDM. Nga ana tjetër, *Vreme* mbante qëndrim shumë kritik ndaj koalicionit qeveritar. Tendencë e ngjashme u vërejt edhe në mediat në gjuhën shqipe. *Koha* u përqendrua në aktivitetet e BDI-së, partisë në pushtet, dhe fuqimisht kritikonte Demokracinë e Re (DR), Lajmi, nga ana tjetër, kishte qëndrim kritik ndaj aktiviteteve qeveritare dhe BDI-së.

### **Ankesa dhe apele**

KZ ofron disa mundësi ligjore për të mbrojtur të drejtën zgjedhore. Megjithatë, qasja ndaj mjeteve dhe ndihmës ligjore efektive para ditës së zgjedhjeve është e kufizuar, kryesisht për shkak të leximit të ngushtë të kompetencave të organeve të ankesave dhe apeleve. Disa gjykatës nga Gjyqet themelore i thanë MVZ të OSBE/ODIHR se nuk ishin të

---

<sup>14</sup> Siqë është paraparë nga Neni 15 në Rregulloren për Media.

## **vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve**

**Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Zgjedhje të parakohshme, 5 qershor 2011**

### **Deklarata për rezultatet dhe konkluzionet preliminare**

---

njoftuar me rolin e tyre në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të kandidatëve gjatë fushatës zgjedhore.<sup>15</sup>

Para ditës së zgjedhjeve pati tri ankesa zyrtare të paraqitura në KShZ dhe asnjë në gjykatë. KShZ nuk arriti të përcaktonte procedurat për të trajtuar ankesat, që rezultoi me mjete juridike jokonzistente dhe jo në kohë. Nga dy ankesat e diskutuara në seancë para ditës së zgjedhjeve, KShZ pranoi një për të cilën rekomandoi ngritjen e procedurës për kundërvajtje për publikimin e sondazheve jashtë afatit ligjor. Bashkëbiseduesit justifikuan mungesën e ankesave në gjykatë për shkak të besimit të ulët në procedurat e ankimit dhe organet gjykuese.

Prokurori publik ngriti një hetim në një rast të frikësimit të votuesve nga VMRO-DPMNE më 11 Maj.<sup>16</sup> Më 25 maj rreth 20 nëpunës shtetërorë që ishin në lista u thirrën të japin dëshmi. E shumta e tyre nuk u paraqitën në bisedë, ata që u paraqitën mohuan se kishin pasur presion që të votonin për VMRO-DPMNE, sipas Prokurorit publik. Në bazë të këtyre intervistave Prokurori Publik, më 3 qershor, tha se nuk kishte prova të mjaftueshme për të vazhduar procesin. Një hetim tjetër nga një prokuror lokal në Manastir u hodh poshtë më 19 maj pas zhvillimit të dy bisedave duke konkluduar se nuk kishte prova të mjaftueshme për të vazhduar.

### **Pjesëmarrja e grave**

Gratë dhe burrat mirë u përfaqësuan në komisione zgjedhore dhe u plotësua pragu prej 30 për qind që kërkohet nga KZ. Në 84 KKZ rreth gjysma e anëtarëve ishin gra dhe 40 për qind janë kryesuar nga gra. Vëzhgimi gjatë ditës të zgjedhjeve tregoi se 47 për qind i KZ-ve u kryesuan nga gra. I vetmi përjashtim ishte KShZ-ja, ku vetëm një nga shtatë anëtarët është grua.

Sipas KZ, një në tre vendet në listat e kandidatëve duhet të rezervohen për gjininë më pak të përfaqësuar që të sigurohet se të dy gjinitë janë të përfaqësuara në të gjitha listat. Të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje ë plotësuan këtë kusht. 1,679 kandidatë, 566 ishin gra (33.7 për qind).

Në krahasim me zgjedhjet parlamentare, numri i grave kryesuese të listave është rritur prej 6 në vitin 2008 deri më 15 në vitin 2011. Gratë ishin aktive gjatë fushatës dhe të pranishme në media. Por, dukshmëria e tyre ishte më e vogël se ajo e burrave, veçanërisht në zonat rurale.

### **Pjesëmarrja e bashkësive etnike**

---

<sup>15</sup> Gjyqet bazike në Manastirë, Shkup, Shtip dhe Veles.

<sup>16</sup> Televizioni A1 raportoi se VMRO-DPMNE u ka dhënë urdhër udhëheqësve të sektoreve në institucionet shtetërore që të dorëzojnë lista me më se paku 15 persona të cilët do ta japin përkrahjen e tyre për këtë parti dhe si shpërblim do të fitojnë punësim ose përfitime tjera.

*Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.  
Janë siguruar përkthime jozyrtare në shqip dhe maqedonisht.*

## **vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve**

**Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Zgjedhje të parakohshme, 5 qershor 2011**

### **Deklarata për rezultatet dhe konkluzionet preliminare**

---

Identiteti etnik është një nga elementet kryesore që ndikon në formimin e partive politike. Si rezultat i kësaj, skena politike është në masë të madhe e polarizuar në vija etnike, me parti politike kryesore maqedonase dhe shqiptare që garojnë brenda elektoratit të tyre etnik. Dy parti të reja shqiptare, DR dhe Rilindja Demokratike Kombëtare, për herë të parë dolën në zgjedhje parlamentare, me çka u rrit fragmentimi i skenës politike të shqiptarët etnik. Bashkësitë më të vogla përfaqësohen të gjitha nga parti politike etnike të cilat u janë bashkuar koalicioneve parazgjedhore të partive më të mëdha për të pasur mundësi më të mira të artikulimit dhe mbrojtjes së interesave të tyre. Parimi i përfaqësimit të drejtë kryesisht u respektua nga komisionet zgjedhore.

#### **Vëzhguesit lokal**

KZ parasheh praninë e vëzhguesve lokal dhe ndërkombëtarë në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. Disa mija vëzhgues lokal nga shoqëria civile u akredituan për këto zgjedhje. Grupi më i madh i vëzhguesve ishte MOST, dhe një numër i madh u vendos nga Shoqata Humanitare SINERGIJA dhe Education Plus Maqedonia. Vëzhguesit lokal ishin të pranishëm në 83 për qind të vendvotimeve që u vizituan nga vëzhguesit. Më tej, garuesit zgjedhorë vendosën përfaqësues të autorizuar për të vëzhguar në ditën e zgjedhjeve dhe ishin të pranishëm në 96 për qind të vendvotimeve të vizituara nga vëzhguesit.

#### **Dita e zgjedhjeve**

Në përgjithësi, dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe paqësore ku u vërejtën vetëm një numër i kufizuar i parregullsive teknike. Numrat fillestarë të shpallur nga KShZ treguan se dalja në zgjedhje arrin 61 për qind. KShZ filloi me shpalljen e rezultateve që natën e zgjedhjeve dhe të njëjtat i paraqiti në internet faqen e tij të klasifikuara sipas njësive zgjedhore, komunave dhe vendvotimeve.

Votimi i parakohshëm u zhvillua më 4 qershor për votuesit që nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre, të burgosurit, personat e zhvendosur brenda vendit (PZhV), dhe votuesit jashtë vendit. Vlerësimi i përgjithshëm ishte pozitiv në 54 nga 55 rastet e vëzhguara mbarë vendit. Pati disa probleme me disa të burgosur që nuk ishin në LV dhe raste ku fshehtësia e votimit nuk u respektua në rastet e votimit të personave që nuk mund të dalin nga shtëpia.

Vëzhguesit ndërkombëtar vlerësuan hapjen e vendvotimeve pozitivisht në 114 prej 116 vendvotimeve të vizituara. Vëzhguesit vërejtën se 26 vendvotime të vëzhguara nuk u hapën në kohë. Megjithatë, vonesat e konstatuara nuk zgjatën dhe nuk cenuan të drejtën e votuesve.

Procesi i votimit u vlerësua si i mirë ose shumë i mirë në 97 për qind të vendvotimeve pa ndonjë dallim të theksuar mes vendbanimeve maqedonase dhe ato etnike shqiptare. Puna *Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar. Janë siguruar përktihme jozyrtare në shqip dhe maqedonisht.*

## **vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve**

**Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Zgjedhje të parakohshme, 5 qershor 2011**

### **Deklarata për rezultatet dhe konkluzionet preliminare**

---

e KZ-ve u vlerësua si e mirë ose shumë e mirë në 94 për qind të vendvotimeve dhe njohja që ata kishin për procedurën e votimit u vlerësua pozitivisht në 94 për qind të vëzhgimeve. Hapësirat e votimit u vlerësuan si jopërkatese dhe të stërbushura me njerëz në një nga njëzet vëzhgime.

Parregullsitë procedurale të vërejtura gjatë procesit të votimit janë: 115 raste të problemeve me fshehtësinë e votës (10 për qind), kryesisht për shkak të renditjes së vendvotimit; 38 raste të kutive të votimit të mbyllura në mënyrë të gabuar (3 për qind); dhe 173 raste të votimit familjar (15 për qind).

Numërimi i votave u vlerësua si i mirë ose shumë i mirë në 100 nga 114 KZ të vëzhguar. Në 42 vende ku u vëzhgua numërimi, kopjet e procesverbaleve zyrtare nuk u shpallën publikisht. Paraqitja tabelore në KKZ u vlerësua si e mirë ose shumë e mirë në 98 përqind të atyre që u vëzhguan.

*Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.  
Janë siguruar përkthime jozyrtare në shqip dhe maqedonisht.*

---

#### **INFORMATATA DHE MIRËNJOHJE TË MISIONIT**

---

**Shkup, 6 qershor 2011** – Misioni vëzhgues i zgjedhjeve i OSBE/ODIHR u hap në Shkup më 4 maj, me 15 ekspertë në kryeqytet dhe 20 vëzhgues afatgjatë të vendosur mbarë vendit. AP OSBE zhvilloi një vizitë parazgjedhore më 14 maj dhe delegacioni parazgjedhor i APKE vizitoi Shkupin më 17-18 Maj.

Në ditën e zgjedhjeve, u pozicionuan diku 288 vëzhgues afatshkurtër, duke përfshirë edhe delegacionin 45 anëtarësh nga AP e OSBE, dhe delegacion 15-anëtarësh nga APKE. Gjithsej, kishte vëzhgues nga 41 vende anëtare të OSBE-së. Votimi u vëzhgua në pothuajse 1,200 vendvotime nga gjithsej 2,976. Numërimi u vëzhgua në 114 vendvotime. Procesi i paraqitjes tabelore u vëzhgua në 80 nga 84 KKZ.

Institucionet e përfaqësuara dëshirojnë të falënderojnë autoritetet për ftesën të vëzhgojnë zgjedhjet, Këshillin Shtetërorë të Zgjedhjeve për bashkëpunimin dhe për sigurimin e dokumenteve të akreditimit, dhe Ministrinë e punëve të jashtme dhe organet të tjera për ndihmën dhe bashkëpunimin. Institucionet gjithashtu dëshirojnë të shprehin falënderimin e tyre Misionit të OSBE-së në Shkup dhe institucionet e tjera ndërkombëtare për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre.

#### **Për informata më të hollësishme, ju lutemi kontaktoni:**

- Z. Julian Peel Yates, Shef i Misionit vëzhgues të zgjedhjeve të OSBE/ODIHR, në Shkup;
- Z. Jens Eschenbacher, zëdhënës i OSBE/ODIHR (+48 603 683 122);

*Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.  
Janë siguruar përkthime jozyrtare në shqip dhe maqedonisht.*

## **vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve**

**Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Zgjedhje të parakohshme, 5 qershor  
2011**

### **Deklarata për rezultatet dhe konkluzionet preliminare**

---

- Z. Neil Simon, Drejtor i komunikimit i AP OSBE (+45 60 108 380);
- Z. Chemavon Chahbazian, APKE (+33 607 067 773)

#### **Adresa e MVZ të OSBE/ODIHR:**

Rruga 27 Mart, 1000, Shkup

Tel: +389 (0)2 3235 900,

Faka: +389 (0)2 3235 901

Email: [office@odihr.org.mk](mailto:office@odihr.org.mk)

*Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.  
Janë siguruar përkthime jozyrtare në shqip dhe maqedonisht.*